



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	16.02.2023
REFERENCË:	01.110/09-0013426/23
PËR/ZA/TO:	znj. Blerina Kastrati - Udhëheqëse e Njesisë së Komunikimit me Publikun / Zyra e Informimit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Egzon Sadiku – Drejtor për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shpallja e diskutimit publik

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për vetëqeverisje lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimit e akteve të komunës; nenin 3 paragrafi 5, nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1.3, të UA Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, Komuna shpall:

DISKUTIM PUBLIK

PËR RREGULLORE NR. /2023 PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.02/2022 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në debatin publik, i cili do të mbahet ditën e **premtë**, me datë **24.02.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora **10:00**.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e Draft-Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, pjesëmarrja e publikut në këtë fazë të procesit është e domosdoshme, prandaj qytetarët dhe të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i japin përmes e-mail adresës elektronike të Komunës së Mitrovicës komuna.mitrovica@gmail.com ose drejtpërdrejt te Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve.

Bashkangjitur gjeni Rregullore Nr. /2023 për plotësim/ndryshimin e Rregullores Nr.02/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Mitrovicës së Jugut